

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep.	2-D / DPK	Nr. Prot.	01-4588/14
Dep.		Br. Prot.	
Dep.	03	Prot No.	
Nr. Fisq.		Data	
Broj Stranica		Datum	
Nr. pages		Prishtine	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPTIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	03.12.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK - DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Salih KQIKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Gjilanit
CC:	z. Lutfi HAZIRI Kryetar i Komunës së Gjilanit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Hartimi i Planeve Rregulluese në Komunën e Gjilanit- ndarja në tri Lote "

Inderuari z. Kqiku ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me " Hartimi i Planeve Rregulluese në Komunën e Gjilanit- ndarja në tri Lote " me numër prokurimi: Gi651-14-114-211, Agjencia kundër Korruptionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull " Hartimi i Planeve Rregulluese në Komunën e Gjilanit- ndarja në tri Lote " me numër prokurimi: Gi651-14-114-211, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Komuna e Gjilanit si Autoritet Kontraktues, përmes Departamentit të Prokurimit ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull "Hartimi i Planeve Rregulluese në Komunën e Gjilanit-ndarja në tri Lote" me numër prokurimi: Gi651-14-114-211 e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.26.11.2014 për të cilën ka paraparë Konratë me vlerë të madhe në Procedurë të Hapur për ketë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues ka paraparë 3 Lote (pjesë) në Lot 1 është paraparë Hartimi i Planit Rregullues të hollësishëm Fidanishte 2, në Lot 2 është paraparë Hartimi i Planit Rregullues të hollësishëm Qarku 3 dhe në Lot 3 është paraparë Hartimi i Planit Rregullues të hollësishëm Zona e Qendrës 2, Zona e Qendrës 3 dhe Lagjja e Spitalit.

Agjencia kundër Korrupsionit duke vepruar sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar ketë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe shqyrtimit të dokumenteve të Dosjes së këtij Tenderi, Agjencia ka hasur në disa kriterë të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar faktet si në vijim:

Në Njoftimin për Konratë dhe Dosjen e këtij Tenderi e cila është përgatitur nga ana e Autoritetit Kontraktues, Agjencia ka vërejtur se si kriter për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka caktuar kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriteret i ka vendosur 1. Metodologjinë e prezantimit dhe konceptet e projektimit të cilin e ka peshuar me 23 %, 2. Metodologjinë e bashkëpunimit me strukturat komunale dhe Komunitetin-diskutimet publike dhe miratimi i planeve të cilat i ka caktuar peshë prej 20 %, 3. Afatin-kohëzgjatjen e kryerjes së planit rregullues për të cilin konkuron të cilin e ka peshuar me 7 % ku për kriteret teknike ka paraparë gjithsej 50 Poena si dhe për Poenat Financiar ka paraparë 50%.

Në lidhje me nën kriteret 1,2 dhe 3 Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se nën kriteret tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kriter për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues, andaj konsiderojmë se nën kriteret e lartëcekura të cilat janë vendosur nga ana e Autoritetit bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimit Publik. Sipas këtij Legjislacioni Autoritetet Kontraktues përveç kriterit për dhënie të kontratës çmimi më i ulët, kanë të drejtë të përdorin si kriter për dhënie edhe kriterin Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, por kur një Autoritet Kontraktues përcaktohet që për dhënie të kontratës ta përdor ketë kriter ai duhet të ketë kujdes që të caktojë çdo herë nën kriteret të qarta, precize dhe të cilat janë të matshme. Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas nenit 23 paragrafi 5 dhe nenit 25 paragrafi 3 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si

kriterë për dhënie të kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteret e vendosura si më lartë nuk janë kriterë të matshme dhe do duhej të caktoheshin si kriterë minimale për kualifikim.

Ajgencia gjithashtu ka vërejtur se tek Rubrika 8.2 e Dosjes së Tenderit është kërkuar që Auditimet duhet të jenë të kryera nga auditorët e licencuar dhe certifikuar sipas ligjit. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporte të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion, *por nuk është e lejuar që të pranohet edhe raporti i auditimit nga një Auditor edhe nëse ai është i licencuar pa u kërkuar i njëjtë nga Kompania e Licencuar e auditimit me reputacion.*

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **52** Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratë, nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin **23** Kriteret e përzgjedhjes dhe nenin **25** Kriteret e dhënies së kontratës e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet të lejohen në Procese të Prokurimit, andaj Ajgencia kundër Korruptionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.



Me respekt !